“MELODITË E MESDHEUT” – NJË MBRËMJE MUZIKORE ME INVA MULËN NË AMFITEATRIN ANTIK TË DURRËSIT

Përgatiti: Mal Berisha

Më 5 gusht 2025, në amfiteatrin antik të Durrësit – një nga skenat më të lashta të artit në brigjet shqiptare të Adriatikut – sopranoja jonë me famë ndërkombëtare, Inva Mula, solli një koncert të paharrueshëm me titullin: “Melodité e Mesdheut”.

E shoqëruar nga dueti Ekland & Redi Hasa dhe kori i fëmijëve “Okarina”, ajo e ktheu këtë mbrëmje në një udhëtim të rafinuar muzikor, që ndërthurte melodité mesdhetare me shpirtin shqiptar dhe elegancën e saj vokale. Përzgjedhja e këngëve – me shumë kujdes, sqimë dhe ndjeshmëri – u interpretua me një klas të lartë artistik, duke dhuruar një përjetim të thellë emocional që lartësoi shpirtin dhe mbeti gjatë në kujtesën e publikut.

Kam pasur kënaqësinë ta ndjek Inva Mulën në shumë skena: nga “King’s Place” në Londër, në koncertet në Gjakovë, në mbrëmjet jubilare përkrah të atit të saj të paharruar, Avni Mula, si dhe në interpretime të mrekullueshme me pianistin Genc Tukiçi. Po ashtu, edhe në Teatrin Migjeni në Shkodër. Por kjo mbrëmje në Durrës kishte një veçanti të thellë: ishte një përqafim simbolik mes historisë dhe artit, mes antikes dhe modernes, mes gurit dhe zërit.
Ishim të pranishëm: unë, bashkëshortja ime Donika dhe motra ime Flutura – të tri zemrat tona rrahnin në të njëjtin ritëm: krenari dhe mallëngjim.

📖 Biografia e Inva Mulës

Inva Mula është një nga figurat më të shquara të artit muzikor shqiptar në skenën ndërkombëtare. E lindur në Tiranë më 1963, në një familje artistësh, ajo ndoqi studimet në Liceun Artistik “Jordan Misja” dhe më pas në Akademinë e Arteve të Tiranës.

Në vitin 1987, ajo fitoi konkursin prestigjioz “George Enescu” në Bukuresht, dhe më pas Grand Prix Operalia të Plácido Domingo-s në Paris, më 1993. Këto suksese i hapën dyert e skenave më të mëdha botërore, si:
La Scala në Milano, Opéra National de Paris, Teatro Real në Madrid, Metropolitan Opera në New York, e shumë të tjera.

Një nga momentet më të njohura në karrierën e saj ishte dublimi i zërit të “Diva Plavalagunës” në filmin fantastiko-shkencor “The Fifth Element” të regjisorit Luc Besson (1997), ku interpretoi pjesë nga “Lucia di Lammermoor” dhe pjesën e famshme “The Diva Dance”.

Përveç arritjeve në skenat ndërkombëtare, Inva Mula ka dhënë një kontribut të veçantë në promovimin e muzikës shqiptare, duke mbajtur titujt “Artiste e Merituar” dhe “Nderi i Kombit”.

📸 Në Arkivën Time

Ky material publikohet në kuadër të punës sime kërkimore dhe dokumentuese për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të kulturës shqiptare – pa asnjë tendencë shoviniste apo nënvleftësuese ndaj kulturave të tjera.

Së bashku me këtë tekst, kam përfshirë edhe një kolazh fotografish nga koncerti dhe nga arkivi im personal, të mbledhura ndër vite, si dëshmi e dashurisë dhe mirënjohjes sime të thellë për këtë artiste të madhe shqiptare.

Mal Berisha

in London
presents
NOTES ON ALBANIA
Second Edition
with Inva Mula
26 November 2014
Kings Place

NOTES ON ALBANIA